



FORCIMI I KORNIZËS SË SINJALIZIMIT NË SHQIPËRI SI NJË HALLKË E RËNDËSISHME NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

DOKUMENT POLITIKASH

AUTOR: JONIDA JANI

IMPRINT

Fondacioni “Friedrich Ebert” | Rr. “Kajo Karafili” Nd. 14,
Hyrja 2 kati i I | Tiranë | Albania

Tel: 00355 4 22 509 86

tirana.fes.de

Friedrich Ebert Foundation publications may not be used for commercial purposes without the written approval of FES.

The opinions, conclusions and recommendations expressed in this publication do not necessarily reflect those of the Friedrich Ebert Foundation or the organizations for which the authors work.

Copyright © All rights reserved to the Friedrich Ebert Foundation (FES) and the Center for the Study of Democracy and Governance (CSDG).

No part of this publication may be reproduced, stored in a retrieval system or transmitted, in any forms or by any means, electronic, mechanical or other, without quoting the Center for the Study of Democracy and Governance (CSDG).

Image by elbgau from Pixabay - Freepik



Forcimi i kornizës së sinjalizimit në Shqipëri si një hallkë e rëndësishme në luftën kundër korrupsionit

Jonida Jani

Përmbledhje

Korrupsioni cënon qeverisjen, zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë, dhe në fund të fundit, sigurinë e përgjithshme të vendit. Ky dokument politikash thekson nevojën e ngutshme për masa efektive kundër korrupsionit dhe nxjerr në pah rolin thelbësor të sinjalizimit në luftën kundër korrupsionit, denoncimin e shkeljeve dhe promovimin e transparencës. Duke vlerësuar panoramën ekzistues kundër korrupsionit në Shqipëri, dokumenti identifikon boshllëqe, veçanërisht në lidhje me sinjalizimin. Për t'i adresuar këto boshllëqe, mbështetur në praktikat më të mira, rekomandohet të ndërmerren disa masa specifike. Këto rekomandime përfshijnë krijimin e një shërbimi këshillimi konfidencial për sinjalizuesit potencialë dhe miratimin e ligjeve të shpërblimit për sinjalizuesit. Gjithashtu, theksohet rëndësia e kultivimit të një kulturë të përgjegjshmërisë dhe integritetit. Duke i dhënë përparësi një strategjie solide kundër korrupsionit, vendi mund të përmirësojë ndjeshëm transparencën, përgjegjshmërinë dhe integritetin, duke bërë kështu progres të dukshëm në luftën kundër korrupsionit. Ky dokument politikash u bën thirrje politikëbërësve dhe palëve të interesuara të ndërmarrin masat e nevojshme për zbatimin e këtyre rekomandimeve, duke ndihmuar në krijimin e një mjedisi që fuqizon dhe inkurajon sinjalizuesit.

I. Rebusi i korrupsionit

Që prej vitit 2000 qeveria shqiptare ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të adresuar korrupsionin. Në këtë aspekt, është forcuar kuadrin ligjor ekzistues, janë miratuar ligje të reja si dhe janë ngritur struktura institucionale kundër korrupsionit. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë disa reforma për të përmirësuar aftësinë e vendit për të parandaluar, frenuar dhe reduktuar korrupsionin. Ndërkohë, nëntë nga dhjetë rekomandimet e GRECO-s¹ janë zbatuar dhe kuadri rregullator për parandalimin e korrupsionit dhe garantimin e integritetit, ndonëse i fragmentuar, është gjithëpërfshirës².

¹ Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit.

² Komisioni Evropian, Raporti “Screening” për Shqipërinë 2023, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en



Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve, sfida e korrupsionit mbetet e mundimshme. Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparencës Ndërkombëtare për vitin 2022, Shqipëria u rendit e 101-ta ndër 180 vende³. Pavarësisht rritjes me një pikë në krahasim me vitin 2021, vendi ende renditet në mesin e më të korruptuarve në Evropë. Për më tepër, për të njëjtin vit, Freedom House e kategorizoi Shqipërinë si një "regjim hibrid/demokraci në tranzicion"⁴, tregues ky i sfidave të vazhdueshme për të vendosur praktika demokratike të qëndrueshme.

Kjo sfida e vazhdueshme reflektohet edhe në sondazhet e opinionit publik. Në vitin 2022, shumica e shqiptarëve (76.5%) e konsideruan korrupsionin e vogël (e nivelit të ulët) si të përhapur ose shumë të përhapur, krahasuar me 79.1% që kanë këtë mendim për korrupsionin e madh (e nivelit të lartë)⁵. Për më tepër, shumica dërrmuese e qytetarëve e perceptojnë korrupsionin si kërcënimin më serioz për sigurinë. Sipas Barometrit të sigurisë së Shqipërisë 2022, të zhvilluar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, shumica e qytetarëve mendojnë se kërcënimi i korrupsionit në Shqipëri është i madh (49.3%) ose shumë i madh (37.7%)⁶. Në të njëjtën kohë, kur u pyetën për rezultatet e luftës kundër korrupsionit, 50.3% e qytetarëve thanë se korrupsioni do të mbetet i njëjtë në vitet në vijim. Në krahasim, 19.5% mendojnë se korrupsioni do të rritet në të ardhmen dhe vetëm 27.1% janë optimistë se korrupsioni do të zvogëlohet.⁷

Nga sa më sipër, persistenca e korrupsionit është e dukshme. Ndërsa Shqipëria përpiqet të pajtojë aspiratat e saj për transparencë dhe integritet me realitetin e hidhur të korrupsionit të rrënjosur thellë, nevoja për zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme bëhet më urgjente se kurrë. Ky rebus thekson domosdoshmërinë për masa më të forta kundër korrupsionit, veçanërisht në njohjen e rolit thelbësor të sinjalizimit. Sinjalizimi është njohur gjerësisht si një mekanizëm i qenësishëm për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit dhe për forcimin e përgjegjshmërisë dhe transparencës demokratike. Sinjalizimi i referohet aktit të dikujt që raporton një shqetësim ose zbulon informacion mbi veprime dhe mosveprime që paraqesin një kërcënim ose dëm ndaj interesit publik, të cilin ata e kanë hasur në vendin e tyre të punës⁸. Sinjalizuesit veprojnë si katalizatorë të rëndësishëm, duke zbuluar akte të dyshuara korrupsioni dhe duke promovuar transparencën. Ata sigurojnë zbatimin efektiv të sistemeve kombëtare të llogaridhënies duke u lejuar atyre të cilët janë

³ Transparenca Ndërkombëtare, 2022, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, <https://www.transparency.org/en/cpi/2022/index/alb>

⁴ Freedom House, Vendet në Tranzicion 2022, Shqipëria, <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2022>

⁵ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Sondazhi i opinionit publik 2022: Besimi në qeverisje, Edicioni i 10-të <https://idmalbania.org/publication-of-the-10th-edition-of-trust-in-governance-annual-public-opinion-poll-in-albania/>

⁶ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Barometri i sigurisë Shqipëri, Anketë Kombëtare 2022. <https://csdgalbania.org/albanian-security-barometer-2022/>

⁷ Po aty.

⁸ Këshilli i Evropës. Tetor 2014. Mbrojtja e sinjalizuesve: Rekomandim CM/Rec (2014)7 dhe memorandum shpjegues.



ligjërisht përgjegjës për shpërdorimin (keqadministrimin) e supozuar, mundësinë për ta adresuar problemin dhe mbajtur përgjegjësi për veprimet e tyre.⁹

II. Korrupsion i lartë, raportim i ulët

Në vitin 2016 Shqipëria miratoi ligjin "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve".¹⁰ Sipas ligjit, "sinjalizim" është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit.¹¹ te njësia përgjegjëse ose pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij/saj të punës në autoritetin publik apo subjektin privat.¹² Ligji kërkon që autoritetet publike me më shumë se 80 të punësuar, dhe subjektet private me më shumë se 100 të punësuar, të caktojnë një "njësi përgjegjëse" për të regjistruar, hetuar administrativisht dhe shqyrtuar sinjalizimet.¹³ Ndërkohë, sinjalizimi i jashtëm është nën autoritetin e ILDKPKI-së, kur sinjalizuesi zgjedh të mos raportojë te njësia përkatëse përgjegjëse në autoritetin publik ose subjektin privat ose kur nuk ka një njësi të tillë.¹⁴ Në këtë kuadër, janë ngritur dhe veprojnë 362 njësi përgjegjëse në sektorin publik, si dhe 527 njësi përgjegjëse në sektorin privat.¹⁵

Pavarësisht këtyre masave dhe duke marrë parasysh nivelin e lartë të korrupsionit, numri i rasteve të regjistruara të sinjalizimit tek njësitë përgjegjëse dhe/ose tek ILDKPKI mbetet i ulët. Gjatë vitit 2021, janë raportuar vetëm 8 raste në njësitë përgjegjëse në dy institucione publike, ndërkohë një rast është tërhequr. Njësitë përgjegjëse në sektorin privat nuk kanë regjistruar dhe raportuar asnjë rast për vitin 2021.¹⁶ Njëkohësisht, ILDKPKI-ja ka dokumentuar 11 raste të raportuara për të njëjtin periudhë, 10 prej tyre nga sektori publik dhe 1 nga sektori privat. Për më tepër, pranë ILDKPKI-së është paraqitur 1 kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja.¹⁷

Duke marrë parasysh historinë e Shqipërisë meurvejimin e qytetarëve nga policia sekrete gjatë regjimit komunist, sinjalizuesit historikisht janë etiketuar si "hafije"

⁹ Po aty.

¹⁰ Ligji Nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve."

¹¹ "Sinjalizues" është individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni. Ligji Nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Po aty, Neni 3, pika 13.

¹² Po aty, Neni 3, pika 10.

¹³ Po aty, Neni 10.

¹⁴ Në autoritetet publike me më pak se 80 të punësuar, dhe subjektet private me më pak se 100 të punësuar.

¹⁵ Raporti vjetor i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, 2021, <https://www.ildkpk.al/raporte-vjetore/>

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty.



dhe "spiunë".¹⁸. Fatkeqësisht, mediat e kanë ruajtur këtë stigmë.¹⁹. Në mënyrë inkurajuese, situata po ndryshon gradualisht. Siç theksohet nga Barometri i sigurisë së Shqipërisë, shumica dërrmuese (85.5%) e të anketuarve i konsiderojnë ata që raportojnë/denoncojnë korrupsionin si qytetarë të interesuar dhe të angazhuar, sesa informatorë apo spiunë, një term që media e përdor shpesh, sikurse u theksua edhe më sipër.²⁰. Megjithatë, një hendek i konsiderueshëm në ndërgjegjësim vazhdon të ekzistojë. Kështu, vetëm 26.8% e të anketuarve thonë se kanë dëgjuar për ligjin "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", ndërsa 73.2% e tyre thonë se as nuk e njohin dhe as nuk kanë dëgjuar për ligjin.²¹.

Kjo diskrepancë thekson faktin që qytetarët e njohin efikasitetin potencial të sinjalizimit si një mjet të fuqishëm kundër korrupsionit, por, nga ana tjetër, vërehen mangësi në ndërgjegjësim rreth masave ligjore specifike dhe mekanizmave të përshtatura për t'i mbrojtur dhe fuqizuar ata si sinjalizues. Ndërsa njohja e sinjalizimit si një manifestim i qytetarëve të angazhuar shënon një ndryshim të rëndësishëm pozitiv në perspektivën e shoqërisë, ky perceptim duhet të evoluojë në një kuptim të plotë të rregullave të ligjit. Më poshtë do të diskutojmë metodat që rekomandohet të ndiqen për të transformuar pikëpamjet në veprime konkrete kundër korrupsionit.

II. Lidhja e perceptimit me realitetin: Fuqia e fushatave të ndërgjegjësimit

Organizimi i fushatave të sensibilizimit (ndërgjegjësimit) është një strategji thelbësore për të adresuar hendekun mes perceptimeve të publikut dhe raportimit/denoncimit të informacionit mbi veprime që çenojnë ose dëmtojnë interesin publik. Këto fushata janë baza për kultivimin e qëndrimeve pozitive të publikut dhe lehtësimin e raportimit për akte të dyshuara korrupsioni.²². Është e rëndësishme që punonjësit në sektorin publik dhe privat, si dhe palët e interesuara të kuptojnë rëndësinë e sinjalizimit dhe të jenë të mirëinformuar për ligjet dhe procedurat përkatëse për mbrojtjen e tyre. Kur hartohen me kujdes dhe zbatohen me përpikëri, fushatat e ndërgjegjësimit mund të transformojnë ndjeshëm praktikatat e denoncimit të korrupsionit. Kjo mbështetet edhe nga opinioni publik, ku 68.1% e

¹⁸ Dymishi, Arjan, Hroni, Elira dhe Egest Gjokutaj, Nëntor 2013, Mbrojtja e sinjalizuesve në Shqipëri: Një vlerësim i legjislacionit dhe praktikës, Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

¹⁹ <http://www.panorama.com.al/si-survejohet-administrata-e-biznesi-me-609-spiune-raporti-i-ildkpi-rastet-qe-u-gjeten/>

²⁰ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Barometri i sigurisë Shqipëri, Anketë Kombëtare 2022. <https://csdgalbania.org/albanian-security-barometer-2022/>

²¹ Po aty.

²² Këshilli i Evropës. Tetor 2014. Mbrojtja e sinjalizuesve: Rekomandim CM/Rec (2014)7 dhe memorandum shpjegues.



qytetarëve të anketuar pajtohen me idenë se fushatat ndërgjegjëse dhe edukuese mund të kontribuojnë në uljen e korrupsionit.²³

Ndikimi i fushatave të ndërgjegjësimit shtrihet përtej ndryshimit të kulturës dhe gjuhës që rrethon sinjalizimin, ato mund të thyejnë barrierat dhe konotacionet negative të lidhura me sinjalizimin.²⁴ Dezinformimi dhe keqkuptimet shpesh i dekurajojnë qytetarët të ndërmarrin hapa për të raportuar informacione në lidhje me akte që kërcënojnë ose dëmtojnë interesin publik. Këto fushata mund të luajnë një rol kyç duke riformësuar perceptimin e publikut dhe duke theksuar se sinjalizuesit nuk janë spiunë, por qytetarë të angazhuar. Në përputhje me këtë qëllim, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave është i detyruar të ndërgjegjësojë publikun për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, si dhe të rrisë pranimin kulturor të sinjalizimit.²⁵

Për më tepër, fushatat e ndërgjegjësimit fuqizojnë qytetarët duke siguruar që ata të jenë të mirëinformuar për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre kur raportojnë korrupsionin. Në përputhje me këtë përpjekje, qeveria ka parashikuar masa konkrete në "Planin Kombëtar të Veprimit 2023-2025"²⁶ për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të edukuar publikun e gjerë rreth mekanizmave në luftën kundër korrupsionit. Duke e bërë kuadrin ligjor lehtësisht të kuptueshëm dhe të aksesueshëm, sinjalizuesit e mundshëm mund të angazhohen me besim në procesin e sinjalizimit. Një shembull i suksesshëm vjen nga Serbia, ku ligji i detyron punëdhënësit të vendosin rregullat e brendshme të sinjalizimit në vende të dukshme.²⁷

Seksionin vijues do të shqyrtojë avantazhet e ngritjes së një *shërbimi të këshillimit konfidencial* për sinjalizuesit e mundshëm.

IV. Shërbimi i këshillimit konfidencial për sinjalizuesit e mundshëm

Numri i ulët i rasteve të sinjalizimit në Shqipëri thekson nevojën kritike për një shërbim këshillimi efektiv dhe të aksesueshëm që fuqizon sinjalizuesit e mundshëm. Ndërsa ILDKPKI ofron udhëzime për mekanizmat e sinjalizimit të brendshëm dhe sinjalizimit të jashtëm²⁸, kuadri ligjor nuk ofron mbështetje tjetër për sinjalizuesit e mundshëm. Në të kundërt, Këshilli i Evropës thekson rëndësinë e qasjes në këshillim të fshehtë për individët që kanë hasur në veprime apo praktika të dyshuara

²³ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Barometri i sigurisë Shqipëri, Anketë Kombëtare 2022. <https://csdgalbania.org/albanian-security-barometer-2022/>

²⁴ OECD, 2016, Angazhimi për mbrojtjen efektive të sinjalizuesit, Paris: OECD Publishing.

²⁵ Ligji Nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Neni 2.

²⁶ Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Plan i Kombëtar i Veprimit 2023-2025, Mars 2023.

²⁷ Terracol, Marie. 2018. Një udhëzues i praktikës më të mirë për legjislacionin e sinjalizimit. Berlin: Transparenca Ndërkombëtare.

²⁸ Ligji Nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Neni 21



korupsioni në vendin e punës²⁹. Një shërbim i tillë këshillimi vepron si një hap ndërmjetës që mund të përmirësojë ndjeshëm efektivitetin e proceseve të sinjalizimit.

Shërbimi i këshillimit konfidencial do të ofronte një platform të sigurtë për sinjalizuesit e mundshëm për të kërkuar udhëzime lidhur me raportimin. Kur punonjësit përballen me një situatë ku kanë qenë dëshmitar të një veprimi apo akti të dyshuar korupsioni, shpesh kanë pasiguri rreth mënyrës se si të veprojnë. Kjo është veçanërisht e vlefshme në një kontekst ku pasojat e sinjalizimit mund të jenë të paqarta ose frikësuese. Një shërbim i tillë "siguron që informacioni të arrijë te personi ose organi i duhur në kohën e duhur dhe ndihmon në mbrojtjen e sinjalizuesit si dhe ndihmon punëdhënësin dhe publikun duke siguruar që raporti të bëhet me përgjegjësi."³⁰ Kjo përmirëson procesin dhe rrit gjasat për marrjen në kohë të masave për të adresuar çështjet e raportuara, duke minimizuar dëmet e mundshmet ose pasojat negative.

Më e rëndësishmja, shërbimi i këshillimit mbron interesat e sinjalizuesve, të cilët shpesh kanë frikë nga hakmarrja si pasojë e veprimeve të tyre. Kështu, 64.2% e qytetarëve shqiptarë raportojnë se kanë frikë nga hakmarrja në rast të denoncimit të një akti apo praktike të dyshuar korupsioni, dhe vetëm 32.2% raportojnë se nuk frikësohen nga hakmarrja³¹. Në këtë kontekst, duke pasur akses në këshillim, sinjalizuesit e mundshëm mund të kuptojnë më mirë mbrojtjen ligjore në dispozicion të tyre dhe hapat që mund të ndërmarrin për të mbrojtur identitetin dhe të drejtat e tyre gjatë raportimit. Kjo siguri inkurajon më shumë individë të dalin përpara pa frikën paralizuese të hakmarrjes.

Për më tepër, nga një shërbim i tillë përfiton jo vetëm sinjalizuesi, por edhe punëdhënësi dhe publiku në përgjithësi. Një proces raportimi i përgjegjshëm dhe i mirëinformuar është thelbësor për të gjithë palët e interesuara. Për punëdhënësin shërbimi ofron një mundësi për të adresuar çështje dhe ndërmarrë veprime korrigjuese menjëherë, duke mbrojtur kështu reputacionin dhe integritetin e organizatës. Për publikun kjo siguron që raportimet bëhen me përgjegjësi, duke minimizuar rrezikun e akuzave të pabaza që mund të çojnë në trazira të panevojshme.

V. Ligjet për shpërblimin e sinjalizuesve

Ndërsa ndërgjegjësimi dhe shërbimet e këshillimit konfidencial janë mënyra efektive për të rritur numrin e raportimeve për veprime apo akte të dyshuara të korupsionit, disa hulumtime sugjerojnë se programet e shpërblimit të sinjalizuesve

²⁹ Këshilli i Evropës. Tetor 2014. Mbrojtja e sinjalizuesve: Rekomandim CM/Rec (2014)7 dhe memorandum shpjegues.

³⁰ Po aty.

³¹ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Barometri i sigurisë Shqipëri, Anketë Kombëtare 2022. <https://csdgalbania.org/albanian-security-barometer-2022/>



janë akoma edhe më efektive në rritjen e numrit të raportimeve. Vende si SH.B.A-ja, Kanadaja dhe Koreja e Jugut kanë ndërmarrë programe shpërblimi që synojnë të rrisin numrin e rasteve të raportuara të korrupsionit³². "Programet e shpërblimit të sinjalizuesve", ose "regjimet e shpërblimit", ofrojnë stimuj financiar për dëshmitarët që raportojnë informacion mbi një shkelje që i ndihmon autoritetet të dënojnë fajtorët dhe të rikuperojnë ose kufizojnë dëmin që ata shkaktojnë.³³

Shpërblimet mund të kenë një efekt të dyfishtë në numrin e sinjalizimeve. Së pari, duke prezantuar një stimul financiar, këto programe kanë tendencë të tërheqin vëmendjen e publikut, duke nxitur një rritje të numrit të individëve të gatshëm të sinjalizojnë³⁴. Vizibiliteti i shtuar jo vetëm motivon sinjalizuesit e mundshëm, por gjithashtu nxit një ndjenjë përgjegjësie kolektive brenda shoqërisë për të luftuar korrupsionin. Premtimi i një shpërblimi të mundshëm ofron një përfitim të prekshëm që inkurajon më shumë individë të ndajnë informacione kritike që ndryshe mund të kishin mbetur të fshehura.

Një shembull i ligjit të shpërblimit është "Ligji për pretendimet e rreme" (False Claim Act), SH.B.A, i cili kërkon pagesën e sinjalizuesve nga 15 deri në 30 për qind të sanksioneve monetare që qeveria mbledh nëse ata ndihmojnë në ndjekjen penale të abuzimeve në lidhje me kontratat qeveritare dhe programe të tjera qeveritare. Akti i pretendimeve të rreme është ligji më i suksesshëm në historinë e ligjeve kundër abuzimit, me 72% të rikuperimeve të abuzimeve që rrjedhin nga raportimi i sinjalizuesve³⁵.

Së dyti, programet e shpërblimit të sinjalizuesve kontribuojnë në çmontimin e stigmës që shpesh lidhet me sinjalizimin³⁶. Këto programe mund të ndryshojnë narrativën mbi sinjalizuesit që shihen si individë të angazhuar që kontribuojnë në të mirën e përbashkët, duke pasur gjithashtu mundësinë për të përfituar nga kontributi i tyre. Ky ndryshim në perceptim mund të fuqizojë sinjalizuesit e mundshëm, duke zbutur frikën e tyre nga hakmarrja dhe duke i nxitur ata të raportojnë.

Të dhënat tregojnë se praktika e ofrimit të stimujve për sinjalizuesit është shumë efikase në nxjerrjen e informacioneve të vlefshme, që shpesh çojnë në ndjekje penale të suksesshme³⁷. Ky ndikim mund të jetë veçanërisht i vlefshëm në Shqipëri,

³² Ato vijnë ose në formën e skemave të përgjithshme të shpërblimit ose në formën e ligjeve "Qui tam". Skemat e shpërblimeve janë programe të thjeshta "para për informacion" që shpërblejnë sinjalizuesit, informacioni i të cilëve çon në një ndjekje penale të suksesshme. Këto janë skema me një shumë fikse parash. Ligjet "Qui tam" lejojnë sinjalizuesin (i njohur si relator) të ngrejë një padi në emër të qeverisë nëse është kryer mashtrim. Relatori atëherë ka të drejtë për një pjesë të fondeve të rikuperuara nëse është denoncimi është i suksesshëm.

³³ Nyreröd, Theo and Giancarlo Spagnolo, (Prill 2018), Mite dhe numra mbi shpërbimin e sinjalizuesve, Stockholm Instituti i Ekonomisë së Tranzicionit

³⁴ Caitlin Maslen, Shtator 2018, Programet e shpërblimit të sinjalizuesve, Transparenca Ndërkombëtare

³⁵ Qendra Kombëtare e Sinjalizimit, Rëndësia e shpërblimit, Ligjet për shpërblimin e sinjalizuesve janë çelësi për të luftuar me sukses mashtrimin dhe korrupsionin, <https://www.whistleblowers.org/the-importance-of-rewards/>

³⁶ Caitlin Maslen, Shtator 2018, Programet e shpërblimit të sinjalizuesve, Transparenca Ndërkombëtare

³⁷ Kohn, Stephen M., Dhjetor 2016, "Rivendosja e fuqisë së kuletës: opsionet legjislative", Dhoma e Përfaqësuesve e Shteteve të Bashkuara, Komiteti për Mbikëqyrjen dhe Reformën e Qeverisë, Nënkomiteti për Operacionet Qeveritare dhe Nënkomiteti për Kujdesin Shëndetësor, Përfitimet dhe Rregullat Administrative.



ku numri i rasteve të sinjalizuara të korrupsionit mbetet relativisht i ulët. Duke shtuar dispozitat e shpërblimit të sinjalizuesve në kuadrin ligjor për sinjalizimin, vendi mund të shfrytëzojë një burim informacioni të pashfrytëzuar më parë për aktivitetet korruptive, duke çuar në hetime më të plota, veprime ligjore dhe reduktim të mundshëm të praktikave korruptive.

Për më tepër, përfshirja e ligjeve të shpërblimit të sinjalizuesve në kuadër të kornizës kundër korrupsionit në Shqipëri paraqet një mundësi për të përmirësuar aftësinë e vendit për të identifikuar dhe adresuar raste të korrupsionit. Duke ofruar stimuj financiarë, vendi mund të inkurajojë qytetarët të raportojnë. Për më tepër, dërgon një mesazh të fortë se lufta kundër korrupsionit është një përgjegjësi kolektive dhe që individët që kontribuojnë në këtë qëllim do të njihen dhe shpërblehen siç duhet. Në këtë mënyrë, ligjet e shpërblimit mund të shërbejnë si katalizator në rritjen e numrit të rasteve të raportuara, duke kontribuar në një shoqëri më transparente dhe më të përgjegjshme.

VI. Përfundime dhe rekomandime

Sinjalizuesit janë thelbësor në luftën kundër korrupsionit, duke shërbyer si një kievatë në zbulimin e aktiviteteve që kërcënojnë interesin publik. Adresimi i sfidës së korrupsionit të lartë të perceptuar dhe rasteve të tij të nënraportuara kërkon një qasje gjithëpërfshirëse. Përmes zbatimit strategjik të fushatave të ndërgjegjësimit, ngritjes së shërbimit të këshillimit konfidencial dhe miratimit të ligjeve të shpërblimit të sinjalizuesve, mund të mbushet hendeuku mes shqetësimeve në rritje lidhur me korrupsionin dhe raportimeve të ulta. Të zbatuara së bashku këto nisma do të ndihmonin në ndërtimin e një shoqërie më transparente dhe më të përgjegjshme. Nga ana tjetër, duke kultivuar një kulturë të përgjegjshmërisë dhe duke forcuar zërat e sinjalizuesve, Shqipëria mund të drejtohet me vetëbesim drejt transparencës dhe të nisë një fazë transformimi thelbësor.

Në këtë kontekst, rekomandohet që ILDKPKI të shtojë përpjekjet për të zhvilluar fushata të ndërgjegjësimit për të edukuar punonjësit në autoritetet publike dhe sektorin privat mbi të drejtat dhe mbrojtjen e ofruara për sinjalizuesit sipas ligjit.

Për më tepër, nxitet bashkëpunimi mes ILDKPKI-së, institucioneve qeveritare dhe medias për të zhvilluar fushata të ndërgjegjësimit që informojnë qytetarët mbi të drejtat e tyre, shfuqizojnë ide të gabuara dhe adresojnë shqetësime rreth sinjalizimit.

Gjithashtu, rekomandohet që Parlamenti të ndërmarrë hapa proaktivë për të plotësuar kuadrin ligjor ekzistues. Konkretisht, ngritja e shërbimit të këshillimit konfidencial duhet të jetë prioritet. Ky shërbim do t'u siguronte sinjalizuesve këshilla dhe udhëzime gjatë procesit të sinjalizimit.



Së fundi, Parlamenti nxitet të miratojë masa ligjore/nënligjore për integrimin e ligjeve të shpërblimit të sinjalizuesve. Bazuar në praktikën më të mira, këto ligje do të ofronin një bazë të qëndrueshme për nxitjen e sinjalizuesve të cilët paraqesin informacion të çmuar për korrupsionin.

Bibliografia

- Dyrmishi, Arjan, Hroni, Elira dhe Egest Gjokutaj, Nëntor 2013, *Mbrojtja e sinjalizuesve në Shqipëri: Një vlerësim i legjislacionit dhe praktikës*, Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.
- Freedom House, *Vendet në Tranzicion 2022*, Shqipëria, <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2022>
- Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, *Sondazhi i opinionit public 2022: Besimi në qeverisje*, Edicioni i 10-të <https://idmalbania.org/publication-of-the-10th-edition-of-trust-in-governance-annual-public-opinion-poll-in-albania/>
- Këshilli i Evropës. Tetor 2014. *Mbrojtja e sinjalizuesve: Rekomandim CM/Rec (2014)7 dhe memorandum shpjegues*.
- Komisioni Evropian, *Raporti “Screening” për Shqipërinë 2023*, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en
- Kohn, Stephen M. “*Rivendosja e fuqisë së kuletës: opsionet legjislative*”. Dhjetor 2016. Dhoma e Përfaqësuesve e Shteteve të Bashkuara, Komiteti për Mbikëqyrjen dhe Reformën e Qeverisë, Nënkomiteti për Operacionet Qeveritare dhe Nënkomiteti për Kujdesin Shëndetësor, Përfitimet dhe Rregullat Administrative.
- Ligji Nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”
- Maslen, Caitlin. Shtator 2018. *Programet e shpërblimit të sinjalizuesve*. Transparenca Ndërkombëtare
- Nyreröd, Theo and Giancarlo Spagnolo, (Prill 2018), *Mite dhe numra mbi shpërbimin e sinjalizuesve*, Stockholm Instituti i Ekonomisë së Tranzicionit.
- OECD, 2016, *Angazhimi për mbrojtjen efektive të sinjalizuesit*, Paris: OECD Publishing.
- Partneriteti për Qeverisje të Hapur, *Plani Kombëtar i Veprimit 2023-2025*, Mars 2023.
- Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, *Barometri i sigurisë Shqipëri, Anketë Kombëtare 2022*. <https://csdgalbania.org/albanian-security-barometer-2022/>
- Qendra Kombëtare e Sinjalizimit, *Rëndësia e shpërblimit, Ligjet për shpërblimin e sinjalizuesve janë çelësi për të luftuar me sukses mashtrimin dhe korrupsionin*, <https://www.whistleblowers.org/the-importance-of-rewards/>
- Raporti vjetor i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, 2021, <https://www.ildkpk.al/raporte-vjetore/>



- Terracol, Marie. 2018. *Një udhëzues i praktikës më të mirë për legjislacionin e sinjalizimit*. Berlin: Transparenca Ndërkombëtare
- Transparenca Ndërkombëtare, *Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2022*, <https://www.transparency.org/en/cpi/2022/index/alb>